



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program **Menaxhimi i projekteve (120 SETK)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120

### Përshkrimi i programit

Programi studimor menaxhimi i projekteve është një kombinim i balancuar i njohurive thelbësore teorike dhe shkathtësive specifike profesionale. Struktura e programit dyvjeçar përfshin studime të cilat janë në thelb dinamike, integruese dhe interaktive. Programi është dizajnuar për të ofruar një qasje integruese ndaj temave të menaxhimit të projekteve, duke zbatuar këtë koncept përmes mësimdhënies dhe pjesës praktike. Lëndët e përfshira në këtë program janë perspektiva të bazuara në teorinë e cila lidhet ngushtë me zbatimin praktik në botën e biznesit. Ky program u mundëson studentëve fitimin e aftësive të nevojshme dhe përvoja të reja në menaxhimin e projekteve në organizatat private dhe jofitimprurëse. Programi studentëve do t'u mundësojë: ngritjen e nivelit të menaxhimit dhe lidershit të projekteve nga fushat e ndryshme, trajnimin dhe zhvillimin e menaxherëve të projekteve të profilit bashkëkohor: menaxherë të projekteve të gatshme për të ndërmarrë veprime dhe për t'i evituar rreziqet që shoqërojnë çdo iniciativë, individë fleksibilë, vendimtarë dhe të guximshëm, arsimim të menaxherëve të projekteve të kualifikuar dhe profesionalë, me aftësi drejtuese dhe me dëshirë për të trajtuar sfidat e mileniumit të ri; krijimi i menaxherëve të projekteve me perspektiva dhe ngritja e mënyrave të reja të të menduarit, zhvillimin e aftësive për të parashikuar të ardhmen dhe për të pranuar sfidat dhe mundësitë e të tanishmes.

### Karriera

Programi studimor **menaxhimi i projekteve** studentëve u mundëson të pajisen me njohuri teorike dhe praktike për ballafaqim të suksesshëm gjatë inicimit dhe realizimit të iniciativave të ndryshme, respektivisht të projekteve. Ky program përfshin fitimin e shkathtësive për gjenerim të ideve për biznese të reja, shndërrim të tyre në biznese konkrete, formim të ekipeve për realizimin e projekteve, udhëheqje të ekipit projektues, krijimin e kushteve dhe kriterëve për angazhimin e kuadrit për realizimin e projektit, dhe për zhvillimin e mekanizmave e stileve përkatëse në menaxhimin e projekteve.

### Rezultatet e të mësuarit

#### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të nevojshme për funksionet e biznesit në vijim: marketing, financa, modelimit të biznesit, operacionet e menaxhimit, menaxhimin e riskut, udhëheqjen, menaxhimin strategjik, bazat e të drejtës biznesore dhe të planifikimit të biznesit të nevojshme për menaxhimin e suksesshëm të projekteve.

- Ka njohuri të fushave funksionale të menaxhimit të projekteve dhe inxhinieringut,
- Ka njohuri për të kuptuar gjendjen ekonomike kombëtare, rajonale dhe globale të tregut që kërkohet në menaxhimin e projekteve.
- Fiton bazë të fortë për të filluar një projekt të ri dhe përgatitet për një karrierë në menaxhimin e projekteve.
- Ka njohuri mbi vegla të ndryshme për marrjen e vendimeve gjatë menaxhimit të projekteve.

#### Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të shkruar profesionalisht dhe për të zhvilluar më tej projekt-planin e tyre dhe zbatimin e tij në jetën reale.
- Aftësia për të aplikuar parimet e nevojshme në menaxhimin e suksesshëm të një projekti të ri ose ekzistues.
- Aftësi për të ndihmuar në formulimin dhe zbatimin praktik të marketingut të suksesshëm, projekte financiare dhe projektet e përgjithshme të menaxhimit.

#### Aftësitë për të vlerësuar

- Të mendojnë në mënyrë kritike dhe të aplikojnë njohuritë teorike, praktike dhe përvojën për të identifikuar dhe analizuar problemet e biznesit në inxhinieri dhe menaxhimin e projekteve.
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike mundësitë e identifikuara për zbatimin e suksesshëm të projekteve.
- Të mendojnë për strategjinë dhe arsyetimin rreth aktiviteteve që lidhen me zhvillimin, krijimin dhe mirëmbajtjen e modelit të duhur të projektit.

#### Aftësitë e komunikimit

- T'i kuptojnë dinamikën individuale dhe grupore në organizata.
- Veprojnë në mënyrë efektive në punën në grup gjatë përcaktimit dhe zbatimit të projektit të caktuar.
- Të merren efektivisht me njerëz me prejardhje të ndryshme sociale, ekonomike, kulturore dhe fetare, të cilët janë pjesë e një ekipi të projektit.
- Të demonstrojnë një kuptim dhe ndjeshmëri për përgjegjësitë etike, ligjore dhe sociale të kompanive në inicimin dhe zbatimin e një projekti.

- Të jenë efikas në prezantimin e ideve të biznesit në inxhiniering dhe në projekt të caktuar.
- Të demonstrojnë aftësi negociuese kyçe në negocimin e projektit të caktuar.
- Të interpretojnë të dhënat biznesore dhe treguesit ekonomik, si pjesë përbërëse e elaboratit të projektit të caktuar.

#### Aftësitë e të mësuarit

- Të hulumtojnë dhe të zbulojnë burimet e të mësuarit;
- Të aftësohen për mësim individual dhe grupor;
- Të aftësohen për të bërë analiza të biznesit, për të shfrytëzuar literaturë shkencore dhe analizë të opinionëve dhe vlerësimeve të autorëve të tjerë.

## Lista e lëndëve

### Semestri 1

- [6.0 SETK] Metodologjia e hulumtimit
- [6.0 SETK] Bazat e menaxhimit të projekteve
- [6.0 SETK] Planifikimi dhe menaxhimi i resurseve
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 1
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore e lirë 1

### Semestri 2

- [6.0 SETK] Menaxhmenti dhe udhëheqja
- [6.0 SETK] Komunikimi dhe menaxhimi i projektit
- [6.0 SETK] Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore e lirë 2

### Semestri 3

- [6.0 SETK] Evaluimi dhe kontrolli i projekteve
- [6.0 SETK] Zhvillimi i biznesit global
- [6.0 SETK] Kapston projekti (praktikë)
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 3
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 4

### Semestri 4

- [30.0 SETK] Punimi i magjistraturës

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**  
Qëllimi i lëndës është që t'i njohë studentët me thelbin e kërkimit shkencor, me metodologjinë kërkimore, me

procedurat e hulumtimit dhe me llojet e hulumtimeve dhe punimeve shkencore. Vëmendje e veçantë i kushtohet fokusimit të duhur të studentëve në thelbin e kërkimit shkencor, për interpretim të duhur dhe për vlerësimin e rezultateve të anketës, por edhe procesin e shkrimit të punimit shkencor dhe publikimit të tij. Gjithashtu studentët gradualisht njihen me procedurat dhe fazat e përgatitjes dhe shkrimit të tezës.

- **Bazat e menaxhimit të projekteve**

Lënda përfshin: planifikimin efektiv, komunikimin, pastaj zbatimin e projekteve dhe të ideve të projekteve që janë thelbësore për të gjitha llojet e organizatave që vazhdimisht të marrin iniciativa të reja, të ofrojnë shërbime të reja, të zhvillojnë qasje risimtare për ofrimin e shërbimeve, sajimin e komponentëve të rinj, për të hapur ndërtesa të reja, komplekse, etj, për futjen e teknologjive të reja në mënyrë që t'i përgjigjet mjedisit të ndryshueshëm dhe kërkesave të grupeve të synuara. Lënda ofron një hyrje në konceptet themelore dhe metodat për menaxhimin e projekteve. Studentëve u siguron vegla praktike që do t'i përgatisin ata të jenë menaxherë të suksesshëm të projekteve.

- **Planifikimi dhe menaxhimi i resurseve**

Qëllimi i lëndës është që studentët të aftësohen: - të përgatisin dhe të marrin vendime me të cilat sigurohet prodhim dhe shërbime; - të përgatisin dhe të marrin vendime për të kontrolluar prodhimin dhe shërbimet; - të gjejnë një qasje të përshtatshme për të adresuar çdo situatë me çështjet komplekse të lidhura me prodhimin dhe shërbimet; - t'i kuptojnë aktivitetet e ndryshme të organizimit dhe funksionimit të mbarë sistemit të menaxhimit operacional;

- **Menaxhmenti dhe udhëheqja**

Qëllimi i lëndës është të sigurojë një bazë të kuptimit dhe motivimin për zhvillimin e udhëheqjes duke u ofruar studentëve bazat teorike, informatat praktike dhe mundësitë për vetëvlerësim gjë që do t'u mundësonte studentëve të zhvillojnë talentet e tyre drejtuese. Do të analizohet rëndësia në rritje e menaxhimit të informacionit në projektet multidisiplinare dhe strategjive për optimizimin e rrjedhjes së informacionit. Po ashtu, lënda mbulon procesin e lidershipit, mënyrave të ndryshme të udhëheqjes dhe fleksibilitetit të stileve të udhëheqjes.

- **Komunikimi dhe menaxhimi i projektit**

Lënda është një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me udhëzime teorike dhe praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në mjedisin organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe gjatë mbledhjeve, intervistave, si të përgjigjen gjatë intervistimit, negocimit dhe motivimin e atyre që i rrethojnë.

- **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**

Përmes lëndës studentët do të fitojnë njohuri që të jenë në gjendje: - ta kuptojnë thelbin e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit; - t'i identifikojnë elementet kryesore të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe lidhjen tyre me zinxhirë të krijimit të vlerës së shtuar në rrjetet e prodhimit dhe vlerës; - ta shfrytëzojnë potencialin e sistemeve të informacionit për të mbështetur menaxhimin e prokurimit dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit në krijimin e vlerës së shtuar në prodhimtari.

- **Evalumi dhe kontrolli i projekteve**

Lënda prezanton mjetet e nevojshme për vlerësimin dhe kontrollimin e projekteve. Kjo përfshin zhvillimin e një propozimi, vlerësimin dhe rishikimin e propozimprojektit. Elementet hyrëse të propozimit, si vlerësimi i rrezikut potencial, përcaktimi i kostos dhe përfitimet dhe studimi i fizibilitetit analizohen nëpërmjet teknikave tradicionale dhe bashkëkohore.

- **Zhvillimi i biznesit global**

Qëllimi i lëndës është që studentët: - ta kuptojnë dallimin në mes të krijimit global, mirëmbajtjes dhe modifikimit krahasuar me strategjitë ndërkombëtare në aspektin e biznesit ndërkombëtar. - të fitojnë njohuri për të kryer analizën e kostos nga një perspektivë globale. - ta bëjnë SWOT analizën për kompani të ndryshme ndërkombëtare. - ta kuptojnë thelbin e biznesit global ndërkombëtar dhe shfrytëzimin e komunikimit global. - të përcaktojnë dhe të përdorin strategji për vlerësimin e sipërmarrjeve të përbashkëta (Joint Venture), bashkimin dhe blerjen e kompanive të ndryshme për të fituar qasje në tregjet e reja. - të gjejnë zgjidhje për segmentimin e tregjeve si dhe mënyrave për të hyrë në to.

- **Kapston projekti (praktikë)**

Qëllimi i lëndës është që studentëve t'u ofrojë mundësi që gjatë semestrit të zgjidhin probleme reale të biznesit në kompanitë që do t'i përzgjedhin vet, në ekipe prej 3-4 studentësh. Studentët do të punojnë së bashku si një ekip këshilldhënës në një kompani të veçantë dhe do të kërkojnë zgjidhje për problemet e kompanisë, zgjidhje - e cila do të vihet në përdorim nga kompania. Ekipe të studentëve zhvillojnë analiza dhe rekomandime në dy afate duke

përfunduar projektin me dorëzimin edhe prezantimin e raportit përfundimtar para udhëheqjes së kompanisë.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit. Pas versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor-shkencor formon komision tre anëtarësh, i cili përgatit raport, me çka pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor-shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike. Pas kryerjes me sukses të mbrojtjes, studenti pajiset me diplomë – Magjistër i shkencave ekonomike / Drejtimi: Menaxhimi i projekteve.

## Lëndë zgjedhore

- **Analiza dhe menaxhimi i riskut**

Pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të: - identifikojnë dhe kategorizojnë burime të ndryshme të riskut; - dizajnojnë procesin e menaxhimit të riskut; - kuptojnë rolin e menaxherit të riskut; - kuptojnë rëndësinë që ka menaxhimi i riskut për aksionarët dhe aktorë të tjerë; - mësojnë se si të ndërmarrin vendime sa më të mira të biznesit, ku rendimenti është më i lartë në raport me nivelin e riskut; - kryejnë e matjen dhe vlerësimin e rrezikut duke përdorur teknika dhe modele të përshtatshme (var, skenar analiza, testimi i stresit, etj.) - aplikojnë menaxhimit të integruar të riskut.

- **Menaxhimi i cilësisë dhe sigurisë**

Qëllimi i lëndës është të tregohet rëndësia e teknikave MCT (Menaxhimi i cilësisë totale) dhe përparësitë e përdorimit të tyre në mënyrë që në të ardhmen e afërt të kemi një pasqyrë të re të kompanive të Maqedonisë. Lëndë hulumtimi janë teknikat e MCT. Në vitet e fundit shumë kompani i përdorin këto teknika si mjet kryesor për përgjigje ndaj konkurrencës gjithnjë në rritje në tregun global. Lënda është një përpjekje për një analizë të hollësishme të teknikave dhe të teorive më të njohura të MCT. Gjithashtu, lënda do të pasqyrojë gjendjen reale të MCT në Maqedoni, problemet dhe mundësitë e aplikimit të teknikave të MCT në mënyrë më efektive.

- **Menaxhimi me shpenzimet dhe buxhetin e projektit**

Lënda fokusohet në zbatimin praktik të analizës së kostove dhe të ardhurave të një projekti të veçantë. Qëllimi i lëndës është që t'i pajisë studentët me shkathtësi kyçe analitike për procesin e planifikimit për të ardhmen dhe vlerësimin e performancave të kaluar të projekteve.

- **Menaxhimi i projekteve në industrinë e shërbimeve të integruara**

Lënda mbulon menaxhimin e projekteve në industrinë e shërbimeve të integruara, siç janë: menaxhimi i mbeturinave, i ujit, naftës, gazit etj. Menaxhimi i mbeturinave në shoqëritë moderne ofron një pasqyrë globale të praktikave të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë implikimet mjedisore, sociale dhe ekonomike mbi gjenerimin dhe trajtimin e mbeturinave, me një theks të veçantë mbi politikën, strategjitë dhe çështjet e komunitetit. Lënda mbulon tema të tilla si operacionet në lidhje me digat dhe rezervuarët, zhvillimin e burimeve ujore, kontrollin e rrjedhës së ujërave, GIS aplikimet në inxhinieringun e burimeve të ujit.

- **Menaxhimi i projekteve në ndërtimtarë**

Lënda përfshin një gamë të gjerë të aktiviteteve të ndërtimit, hetimit paraprak të punës dhe operacioneve të lidhura me lëvizjen e tokës, ndërtimit të betonit, metalit dhe drurit. Përveç teknikave, theksi vendoset edhe në rolin e produktivitetit dhe menaxhimin e teknikës së konstruksionit. Industria e ndërtimit ka një histori të sigurisë së ulët, prandaj lënda i pajis studentët me njohuri të politikave të përzgjedhura të menaxhimit dhe të aktiviteteve që përdoren në këtë industri dhe që duhet të merren parasysh gjatë inicimit dhe drejtimit të projekteve të tilla.

- **Analiza statistikore me menaxherë projektsh**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri rreth: - Përdorimit të analizës deskriptive gjatë analizës së të dhënave; - Përdorimit të probabilitetit dhe variablave të rastit në zgjidhjen e problemeve të biznesit; - Konkluzioneve statistikore që janë bazë për interpretimin e rezultateve dhe marrjen e vendimeve të biznesit; - Përdorimit të korrelacionit dhe regresionit të shumëfishtë dhe të thjeshtë; - Bazave të variablave; - Bazave të numrave indeks dhe metodave për analizë të serive kohore.

- **Menaxhimi me ekipin e projektit**

Qëllimi i lëndës është që t'i njoftojë studentët me parimet, rëndësinë dhe rolin e ekipit të menaxhimit të projekteve të

biznesit modern. Në këtë lëndë studentët do të mësojnë gjëra që kanë të bëjnë me procesin e menaxhimit të ekipit të projektit, duke filluar me përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, drejtimin dhe shpërblimin e çdo individi i cili është pjesë e një projekti.

- **Menaxhimi i ndryshimeve organizative**

Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me rëndësinë dhe rolin e menaxhimit me ndryshimet organizative në organizata moderne biznesore. Në këtë lëndë studentët do të njihen me procesin e menaxhimit të ndryshimeve të kompanive ndërkombëtare dhe vendore, në teori dhe në praktikë.

- **Teknologjitë informative në menaxhimin e projekteve**

Objektivat e lëndës janë që studentët: - T'i kuptojnë dhe t'i aplikojnë konceptet e tregtisë elektronike / E-biznes. - T'i identifikojnë nevojat e biznesit për t'iu përshtatur ndryshimeve permanente në mjedis dhe ta kuptojnë rëndësinë e përfshirjes së teknologjisë informative në proceset më të rëndësishme të biznesit. - Ta përmirësojnë performancën e tyre aktuale e operative dhe ta transformojnë në një avantazh konkurrues. - Të zhvillojnë plane strategjike, administrative dhe operative për bizneset e reja apo t'i përmirësojnë ato ekzistuese me teknologjitë e reja. - Të shpjegohen: rritja e E-biznesit deri në ditët e sotme, termi konsumator i biznesit dhe modeli biznes-biznes, duke përdorur teoritë relevante të biznesit, menaxhmentit dhe shkencave sociale. - Të shqyrtohet: ndërveprimi midis trendeve teknologjike dhe kontekstit social të biznesit të E-biznesit, duke përfshirë edhe përhapjen e rrjeteve sociale dhe ueb zhvillimeve 2.0.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjim të shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari i përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxënit si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplaset me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: \* T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. \* T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. \* Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: - T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. - T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuar nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. - Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit

dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.